



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
I SANKSIONEVE

Data: 04 Mars 2022

Nr: 09

VENDIM

PËR

**MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 04, PARAQITUR NË  
KQZ NË DATËN 03.03.2022**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në mbledhjen e datës 04.03.2022, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Illirjan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, përfaqësuar në cilësinë e partisë udhëheqëse “Lëvizja Socialiste për Integrim” nga z. Altin Kaziaj

**OBJEKT:** Ndryshimi i vendimit të Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 116, datë 02.03.2022

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 123/1, 124/1, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe pika 8, e nenit 9, të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.



## **Rrethanat e çështjes:**

1. Kryetarja e Bashkisë Shkodër, me shkresat nr. 2847 prot., datë 22.2.2022, nr. 3179 prot., datë 25.02.2022 dhe nr. 3288 prot., datë 28.02.2022 ka paraqitur kërkesë pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për dhënien e autorizimit nga ana e KQZ-së, për ndryshimin e 12 (dymbëdhjetë) qendrave të votimit të njërive administrative Shalë, Shosh dhe Pult, me arsyetimin se, për shkak të kushteve atmosferike të momentit dhe të parashikimit sinoptik për ditën e zgjedhjeve, vështirësohet ose bëhet i pamundur votimi i shumicës së zgjedhësve të këtyre qendrave të votimit.
2. Rrethanat e parashtruara nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër, vlerësohen prej saj si rrethana që përbëjnë forcë madhore, në kuptimin e fjalisë së dytë të pikës 4 të nenit 62 të Kodit Zgjedhor, për pasojë, formojnë shkak të ligjshëm për të kërkuar autorizimin për ndryshimin e vendndodhjes së këtyre QV-ve.
3. Me vendimin e tij nr.116, datë 02.03.2022, Komisioneri ka refuzuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së qendrave të votimit nr. 0115, 0116, 0117, 0118, 0119, 0119/1, 0132, 0133, 0091, 0092, 0093 dhe 0094, kërkuar nga Bashkia Shkodër, si dhe ka vendosur t'i kërkojë Autoritetit Rrugor Shtetëror dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, marrjen e masave për sigurimin e aksesit të rrugëve dhe energjisë elektrike në zonat e qendrave të votimit në njësitë administrative Shosh, Pult dhe Shalë.
4. Ankuesi nuk ka qenë palë dhe nuk ka marrë pjesë në këtë procedurë administrative, pavarësisht se, sikurse provohet nga administrata e KQZ-së ka qenë informuar për zhvillimin e procedurës. Ankuesi ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 116, datë 02.03.2022, të Komisionerit, më datë 03.03.2022, brenda afatit ligjor të ankimit të parashikuar nga pika 2, e nenit 124/1, të Kodit Zgjedhor.
5. KAS-i caktoi me short relatorin z. Elvis Çefa dhe zhvilloi seancën paraprake në datën 04.03.2022, me praninë e përfaqësuesit të ankuesit z. Altin Kaziaj dhe të administratës së KQZ-së, të përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj.

## **KAS-i konstatoi:**

1. Kompetenca për caktimin e QV-ve është kompetencë e Kryetarit të Bashkisë, të cilën ai e ushtron në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 62 dhe 93 të Kodit Zgjedhor. Kryetarja e Bashkisë Shkodër e ka ushtruar këtë kompetencë, duke caktuar QV-të



nr. 0115, 0116, 0117, 0118, 0119, 0119/1, 0132, 0133, 0091, 0092, 0093 dhe 0094 në territorin e njësisë administrative Shosh, Pult dhe Shalë, sikurse konfirmohet nga shkresa e Kryetares së Bashkisë Shkodër drejtuar KQZ-së me nr. 1165/1 prot., datë 28.01.2022.

2. Fjalja e dytë e pikës 4, të nenit 62, të Kodit Zgjedhor i njeh të drejtën kryetarit të bashkisë që të kërkojë nga KQZ-ja autorizim për të modifikuar vendndodhjen e një apo më shumë qendrave të votimit. *“Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja”*. Mbi këtë bazë, Kryetarja e Bashkisë Shkodër ka vënë në lëvizje procesin administrativ dhe ka kërkuar dhënien e autorizimit për modifikimin e vendndodhjes së QV-ve të sipërcituara.
3. E drejta për të kërkuar autorizimin për të bërë ndryshime në vendndodhjen e QV-ve është e drejtë ekskluzive e kryetarit të bashkisë, sepse buron nga kompetenca e tij ekskluzive për caktimin e vendndodhjes së QV-ve. Subjektet zgjedhore kanë, në raport me procedurën ligjore për caktimin e QV-ve, vetëm të drejtën që të kundërshtojnë në KQZ aktin e caktimit të QV-ve për një ose më shumë qendra votimit, në rast se çmojnë se caktimi i vendndodhjes së tyre është në kundërshtim me *“kërkesat dhe kriteret për qendrën e votimit, numrin e zgjedhësve dhe vendndodhjen e tyre”*, sikurse përcaktohet nga pika 11, e nenit 62, të Kodit Zgjedhor. Në të njëjtën mënyrë, ata e gëzojnë këtë të drejtë edhe përsa i përket aktit për ndryshimin e vendndodhjes së një ose më shumë QV-ve.
4. Ankuesi e ka pranuar si të ligjshëm aktin e Kryetares së Bashkisë Shkodër për caktimin e QV-ve për këtë bashki, sespe nuk ka paraqitur ankim ndaj tij në KQZ. Kjo do të thotë se interesat e tij të ligjshme në raport me caktimin e QV-ve janë kënaqur. Interesat e ligjshme të ankuesit eventualisht mund të cenoheshin, nëse Komisioneri do të autorizonte ndryshimin e këtyre QV-ve. Por kjo gjë nuk ka ndodhur. Me vendimin nr. 116, datë 02.03.2022, Komisioneri ka refuzuar autorizimin për ndryshim, duke mbrojtur atë marrëdhënie juridike që është pranuar dhe pëlqyer nga ankuesi në momentin e caktimit të QV-ve. Për shkak se vendimi nr.116, datë 02.03.2022 nuk modifikon asnjë nga interesat e ligjshme të ankuesit, atëhere ankuesi nuk mund të legjitimohet në të drejtën e ankimit, në cilësinë e tij si palë e tretë.
5. Arsytimi i mësipërm nuk ka lidhje me të drejtën e ankuesit për të marrë pjesë si palë e interesuar në procedurën e shqyrtimit administrativ që zhvillohet nga Komisioneri, apo në procedurën e shqyrtimit të ankimit që zhvillohet nga KAS-i, në rastin kur objekt i shqyrtimit është autorizimi sipas fjalisë së dytë të pikës 4 të nenit 62. Procedurat nuk paragjyken dhe



rezultati i tyre nuk mund të parashikohet. Në një rast të tillë, ankuesi gëzon të drejtën e përfshirjes në proces për të mbrojtur interesin e tij të ligjshëm nga një vendimmarrje që bie ndesh me “kërkesat dhe kriteret e Kodit Zgjedhor për qendrën e votimit, numrin e zgjedhësve dhe vendndodhjen e tyre”. Gjatë shqyrtimit administrativ nga ana e Komisionerit, ankuesi nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë.

6. E drejta e një subjekti për të paraqitur kërkesë ankimore, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tij. Subjektet kanë detyrimin të provojnë legjitimitetin e tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe veprimtarisë që kundërshtohet si e paligjshme. Ankuesi nuk e demonstroi këtë provë përpara KAS-it, sepse nuk ngriti asnjë pretendim paligjshmërie lidhur me vendimin e Kryetares së Bashkisë Shkodër për caktimin e QV-ve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 21, 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenet 17, pika 3, shkronja “b” dhe neni 18, pika 1, shkronja “b” të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve,

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 04, datë 03.03.2022, të paraqitur nga Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

**Elvis**      **ÇEFA**      -      **Relator (Kundër)**

**Elvin**      **LAKO**      -      **Anëtar**

**Illirjan**      **RUSMALI**      -      **Anëtar**

**Ledio**      **BRAHO**      -      **Anëtar**



## MENDIM PAKICE:

1. Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 4 të subjektit politik “Shtëpia e Lirisë” me objekt “Ndryshimi i vendimit nr. 116 datë 02.3.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, të paraqitur në KQZ në datën 03.03.2021, jam kundër vendimit të shumicës për moskalimin për shqyrtim të kësaj kërkesë ankimore për shkak se ankuesi nuk ka legjitimitet, ndaj paraqes në vijim argumentet e mija kundër këtij vendimi:
2. Referuar nenit 123/1 të Kodit Zgjedhor, e drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në i përket (ndër të tjera) kryesisht subjekteve zgjedhore, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së.
3. Referuar nenit 124 të Kodit Zgjedhor, e drejta e ankimit kundër një vendimi të KSHZ i përket (ndër të tjera) edhe çdo partie politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni. Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” në cilësinë e subjektit zgjedhor i regjistruar për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022 me parti udhëheqëse LSI, ka paraqitur Kërkesën Ankimore drejtuar KAS.
4. Natyrisht që, subjekti zgjedhor i cili vë në lëvizje KAS nëpërmjet një ankimi, duhet të provojë se në çfarë mënyre dhe mase vendimi i KSHZ mund të ndikojë apo çënojë një interes të ligjshëm të subjektit apo një aspekt të veprimtarisë së tij.
5. Në opinionin tim, vetë cilësia e qënies si subjekt zgjedhor i cili garon në zgjedhje, përbën kusht të mjaftueshëm për të justifikuar interesin e ligjshëm, i cili në këtë rast konsiston drejtpërdrejt (materializohet) në kryerjen e veprimeve konkrete për mosprivimin e një numri të konsiderueshëm zgjedhësish (rreth 5600 sipas ankimuesit) nga e drejta e tyre kushtetuese për të zgjedhur , apo qoftë edhe thënë ndryshe: kryerjen e veprimeve konkrete për mundësimin e marrjes pjesë në zgjedhje të një numri sa më të lartë votuesish, për të cilët një subjekt zgjedhor mund të pretendojë se janë në shumicë votues të tij.
6. Pikërisht në këtë linjë, shkon edhe parashikimi i bërë në pikën 10 dhe pikën 11 të neni 62 të Kodit. Konkretisht pika 10, jo pa qëllim, iu njeh të drejtën përfaqësuesve të partive politike të akredituara në KQZ që të njihen në çdo kohë me informacionin e dhënë nga kryetarët e njëjësive vendore lidhur me përditësimin e hartës së zonave të qendrave të votimit, si dhe krijimin e bazës së të dhënave mbi vendndodhjet e qendrave të votimit. Po ashtu edhe më konkretisht, pika 11 e këtij neni, u njeh përfaqësuesve të partive politike në KQZ shprehimisht edhe të drejtën që të paraqesin ankesë në KQZ për zbatimin e kërkesave dhe kriterëve për qendrën e votimit, numrin e zgjedhësve dhe vendndodhjen e tyre.



7. Po ashtu në të njëjtën linjë është edhe praktika tashmë e konsoliduar e KQZ, përfaqësuesi i të cilës në këtë procedim administrativ (Sekretari i Përgjithshëm), pretendoi se janë njoftuar të gjithë subjektet zgjedhore për datën dhe orën e zhvillimit të seancës që pasoi me marrjen e vendimit objekt ankimi. Ky fakt konfirmon që ankimuesi ka interes të ligjshëm në shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit administrativ objekt i këtij shqyrtimi.
8. Përfundimisht, nga dispozitat dhe faktet e cituara më sipër, rezulton e qartë se ankimuesi ka interes të ligjshëm në rastin objekt shqyrtimi dhe për këtë arsye Kërkesa Ankimore nr. 4 kundër vendimit nr. 116, datë 02.3.2022 të KSHZ duhet të kalonte për shqyrtim në themel.

**Elvis ÇEFA - Relator**

